

Ceremonia e 8P
E hënë, 26 qershor 2023
Victoria Hall

INFORMACIONE PËR FAMILJEN/PRINDËRIT

Nga ora 13:45 deri në 14:00 – Mbërritja në Victoria Hall

Nxënësit e klasës 8P mblidhen përpara Victoria Hall. Ata vijnë nga shkolla në këmbë ose duke përdorur transportin publik dhe shoqërohen nga mësuesi/-ja/-it e tyre.

Në dispozicion të tyre vendoset një biletë kolektive TPG.

Nga ora 14:15 deri në 15:15 – Ceremonia zyrtare

Nga ora 14:15 deri në 15:15 Victoria Hall pret nxënësit e klasës së 8P dhe mësuesin/-en/-it e tyre për një ceremoni të dedikuar nxënësve që përfundojnë shkollimin e tyre fillor *(fletushkë për t'u shkarkuar në fund të faqes)*.

Është një etapë e rëndësishme në jetën e nxënësve: largimi nga bota e fëmijërisë dhe hyrja në atë të adoleshencës, me sfidat e veta të shumta. Për të shënuar këtë kalim, Qyteti i Gjenevës organizon një eveniment zyrtar, me praninë e autoriteteve, të rezervuar posaçërisht për nxënësit dhe mësuesin/-en/-it e tyre.

Ceremonia e zhvilluar gjatë orarit shkollor nuk është e hapur për prindërit.

Në orën 15:30 – Kthimi në shkolla

Nxënësit kthehen së bashku me klasën e tyre në të njëjtën mënyrë siç erdhën, pra në këmbë ose duke përdorur transportin publik.

Hyrja në Parkun e Bastions

Tramvajet 12, 17 dhe 18

Autobusët 3, 5, 36

Stacioni: Place de Neuve

Informacion

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijë

022.418.48.38

fetedesecoles@ville-ge.ch